

PROCESVERBAL
nga seanca e 24-ët e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 20.6.2022

Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr.Metodija Jançeski.

Anëtarët që mungojnë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr.Dragica Ljubevska, mr.Arben Saiti, mr.Ivona Myfisheva, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska.

Të pranishëm të tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 24-ët të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 12:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë, njëzëri miratoi si në vijim:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur më 14.6.2022.
2. Propozim për inicim të procedurës për marrjen e lejes për emetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Ivanço Pashoski RADIO LAV SHPKNJP Ohër.
3. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Propozim-procesverbalin nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur më 14.6.2022.

Z. Jançeski në Pikën 9 nga procesverbali kishte vërejtje në pjesën e diskutimit të tij në lidhje me terminologjinë dhe propozoi që fjala „ana“ të korrigohej në „faqje“.

Këshilli i Agjencisë pas korrigjimit nga z.Јанчески miratoi njëzëri Procesverbalin nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur më 14.6.2022, me tekst siç ishte propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski arsyetoi Propozimin për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes për emetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Ivanço Pashoski RADIO LAV SHPKNJP Ohër. Sqaroi se ka ardhur Njoftim nga Agjencia për komunikim elektronik për revokim(anulim) të Vendimit për shfrytëzim të radio frekuencave nga 14.4.2022 dhe po ashtu vetë transmetuesi ka njoftuar Agjencinë për revokimin e vendimit. Në këtë drejtim nga ana e Agjencisë më saktë nga Sektori për mbështetje informative dhe çështje të përgjithëshme është dorëzuar vërejtje zyrtare dhe është njoftuar transmetuesi se në afat sa më të shkurtër duhet të mënjanoj pengesat sepse mos transmetimi i shërbimit programor më shumë se 30 ditë paraqet pengesë për marrjen e lejes. Por edhe përveç kësaj që nga 14.4.2022 deri më 20.6.2022 transmetuesi përsëri nuk i ka shlyer detyrimet ndaj AKE-së. Për shkak se më shumë se 30 ditë RA LAV nuk emeton program, Këshillit i'u propozua që të iniciojë procedurë për marrjen e lejes për radio emetim.

Z. Petrushevski citoi se ky është një hap i detyruar që në pajtim me Ligjin Këshilli duhet ta ndër marrë. Ai shpjegoi se pas fillimit të procedurës ka një afat të caktuar prej 15 ditësh që RA LAV të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedurë për marrjen e lejes për emetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Ivanço Pashoski RADIO LAV SHPKNJP Ohër, PA1 nr.08-112 datë 5.1.2015, për shkak se poseduesi i lejes ka ndërprerë transmetimin e shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike financiare dhe arsye të tjera.

Në pajtim me Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer të jashtëzakonshme, sipas detyrës zyrtare mbikëqyrje administrative me nr.03-2401/1 datë 16.6.2022 realizuar në periudhën nga 18.4.2022 deri më 14.6.2022 është konstatuar se SHTR Ivanço Pashoski RADIO LAV SHPKNJP Ohër për më shumë se 30 ditë nuk ka emetuar në radio shërbim programor, që paraqet bazë për marrjen e lejes për emetim në radio në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 nga LSHMAAV.

Z. Petrushevski pas votomit tha se radiodifuzeri duhet të njoftohet sa më shpejtë nëse është e nevojshme përmes telefonit për ta njoftuar se afati prej 15 ditësh fillon të startojë. Ai shpreson se për 15 ditë do të krijohen rrethana pozitive për ndërprerje të procedurës.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr.02-2416/3

01.07.2022

Shkup

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
Krytari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**